



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA TEPELENË
KËSHILLI BASHKAIK**

Nr. 312/14 prot.

Tepelenë, më 03.03.2025

V E N D I M

Nr. 15, datë 27.02.2025

“HEQJE NGA INVENTARI I FONDIT KULLOSOR NË PRONËSI TË BASHKISË TEPELENË ”

Në mbështetje të, pikës 2 të nenit 8, pikës 1.2 germa "a" të nenit 9, të pikave 5 dhe 6 të nenit 27 dhe gërmes "e" të nenit 54 të Ligjit nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen Vendore", Ligjit nr.8480, datë 27.05.1999 "Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike", Ligjit nr.57/2020 "Për pyjet"; ligjit nr.9693 datë 19.03.2007 "Për fondin kullor", të ndryshuar; Udhëzimi nr 2 dt. 20.07.2016 "Për kriteret teknike të klasifikimit të kullotave dhe livadheve dhe procedurat për dhënien e tyre për kullotje dhe kositje bari"; Udhëzimit nr.1 datë 9.6.2016 të Ministrit të Mjedisit "Për rregullat e procedurat e kërkimit, shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënien në përdorim të fondit pyjor dhe kullor publik"; Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.433, datë 08.06.2016 "Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe kullotave publike sipas listës së inventarit, dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit dhe ish-komunave/bashkive" i ndryshuar; Ligj nr. 133/2015 "Për trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kompensimit të pronave" i ndryshuar; VKM nr. 223, datë 23.3.2016 "Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave për vlerësimin dhe ekzekutimin e vendimeve përfundimtare të kompensimit të pronës dhe shpërndarjen e fondit financiar e fizik për kompensimin e pronave" i ndryshuar.

V E N D O S I:

1. Të miratojë, propozimin e Bashkisë Tepelenë për heqjen nga inventari i fondit kullor në pronësi Bashkisë Tepelenë të sipërfaqes prej 30 ha kullotë nga parcela nr.25, Ekonomia Kullosore Sinanaj, sipas Vendimit të Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave ish Pronarëve pranë Prefektit të Qarkut Gjirokastrë nr.1098 datë 19.07.2004, bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Të ngarkohet kryetari i Bashkisë Tepelenë dhe Sektori i Shërbimit pyjor pranë Drejtorisë së Zhvillimit Rural, si dhe Njësitë Administrative për ndjekjen e zbatimit e këtij vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit nr. 139/2015 për "Vetëqeverisjen vendore" të ndryshuar, dhe pas konfirmimit ligjor nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Gjirokastrë.



Sekretari i Këshillit Bashkiak

Valbona ÇELA

KRYETAR I KËSHILLIT BASHKIAK

ARBEN GUMENI



Miratuar me 11 njëmbëdhjetë) vota

Vota Pro 11 (njëmbëdhjetë)vota

Vota Kundër -

Vota Abstenim -

Zbardhur më datë 03.03.2025